

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 1 (një) vend pune për personel ndihmësakademik (Laborant) pranë Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike në Departamentin e Inxhinierisë Fizike.

A. Kandidatët për personel ndihmësakademik (Laborant) në Departamentin e Inxhinierisë Fizike, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të kenë përfunduar studimet universitare në sistemin 3+2 (Bachelor dhe Master i Shkencave) apo diplomë të integruar të nivelit të dytë në Fizikë/Inxhinieri Fizike;
2. Preferohen kandidatët që kanë eksperiencë pune në laborator, fizikë e përgjithshme apo laboratorë shkencorë të institucioneve të arsimit të lartë;
3. Kandidatët të kenë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

II. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 1 (një) vende pune për personel ndihmësakademik pranë Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës në pozicionin “Sekretare Mësimore”.

A. Kandidatët për personel ndihmësakademik në pozicionin “Sekretare Mësimore” pranë Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të zotërojnë diplomë të nivelit të dytë “Master i Shkencave”;
2. Të zotërojnë me dëshmi universitare një gjuhë të huaj perëndimore, preferohet anglisht;
3. Të kenë njohuri të mira të programeve bazë kompjuterike;
4. Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe kërkuese për realizimin e detyrave;
5. Të mos jenë larguar nga puna për masa disiplinore.
6. Të kenë eksperiencë pune në fusha të ngjashme.

III. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **24.04.2024** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.